Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.609/26
Dt.22.10.2026

Nga: **Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)**

Për: **Kryesuesin e Kuvendit z.Enver Rugova**

Kërkese: **për formim të Komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve të Institucioneve Arsimore**

Ne si drejtori Komunale e Arsimit në Istog kërkojmë nga ana e juaj aprovimin e kërkesës tonë për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore.

Kandidatët të propozuar nga DKA për anëtar të komisionit janë:

1. Naim Sadriu- Zyrtar për Standarde, Vlërsim dhe moniturim i/e cili/a përfaqëson DKA-në Krysuse.

dhe

2. Gjyle Sadikaj-Curri- Drejtoreshe në SHFMU "Fan S.Noli" në Llukac të Begut- anëtare

Me këtë kërkesë konfirmoj se personat e shënuar si më lartë i përmbushin kriteret të jenë anëtarë të Komisionit, sipas Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (JEAA) të arsimit parauniversitar.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna Istog
Opština Istok
Istog Municipality

001 Numër:142/2026
Data:22.10.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve te Kuvendit te Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e **10-të** të rregullt të Legjislatura të VIII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet me**: 30.10.2026, e Premte,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00.**

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2026.
4. Raportimi me të dhënat nga shkollat sipas nevojave për Asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit të normave për tatimin në pronë për vitin 2027.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim – Ndryshimit të Rregullores për Subvencione.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim parcela nr. 905-0 dhe 749-1 ZK- Sinajë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim parcela nr. 262-6 ZK-Rakosh.
9. Formimin i komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve në Institucionet Arsimore në Istog.
10. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova
ERugova

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Vërejtje :
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

001 Numër:146/2025
data: 31.07.2025

Rregullorja Komunale

KUVENDI KOMUNAL

RREGULLORE
PËR NDARJËN E SUBVENCIONEVE

Istog, Korrik/2025

Kuvendi i Komunës në pajtim me Nenin 11, Nenin 12 shkronja c), me Nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), me Nenin17, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë, me Nenin 36 paragrafi 3 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parave Publike dhe me Nenin 33, paragrafi 33.1. pika 1 të Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010, i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 30.11.2010, në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.07.2025, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi:

RREGULLOREN
PËR
NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve financiare dhe mundësit qe komuna nga mjetet e veta të fondit buxhetor komunal nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të ndaj mjete financiare si ndihma momentale për persona fizik (individ) dhe persona juridik (OJQ-të jofitimprurëse).

2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor në kategorinë subvencioneve dhe transfere për vitin fiskal, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, e në pajtim më ketë rregullore ndanë mjete financiare (buxhetore) si ndihmë momentale financiare për persona fizik (individ) dhe për persona juridik (OJQ-të jofitimprurëse).

Neni 2
Fushëveprimi

Mjetet financiare nga kategoria ekonomike Subvencionet dhe Transferet janë përkrahje financiare jo të kthyeshme që ndahen për individ, organizata jo qeveritare dhe grupe të interesit me qellim të zhvillimit të aktiviteteve për bujqësi dhe zhvillim rural, shërbime publike dhe emergjenca, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë dhe trashëgimi kulturore, rini dhe sport, arsim, komunitete, mundësi të barabarta gjinore.

Neni 3
Përkufizimit

1. Shprehjet e përdorura në ketë Rregullore kanë ketë kuptim:
   1.1 Subvencione dhe transferet-mjete financiare-që ndahen si ndihmë momentale një herë në

vit, për natyrën e njejtë për personat fizik dhe për një aktivitet për personat juridik (OJQ-të jofitimprurëse) sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara me ligje, akte nënligjore në fuqi dhe me depozitat e kësaj rregulloreje;

1.2. Parat Publike- do të thotë para ose pasuri financiare të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e një organizate buxhetore-Komunës;
1.3. ZKA-Zyrtari Kryesor Administrativ- Kryetari i Komunës;
1.4. ZKF-Zyrtari Kryesor Financiar, që është i emëruar nga Kryetari i Komunës;
1.5. OJQ- Organizatë Jo qeveritare-jo fitimprurëse;
1.6. Person fizik-individ;
1.7. LPPA-Ligji për Procedurën përgjithshme Administrative;
1.8. SIMFK- Sistemi informativ i menaxhimit financiar në Kosovë;
1.9. MFK- Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli;
1.10. OSHQ- Qendra për Shërbim me Qytetar

Neni 4
Programet buxhetore

1. Me këtë rregullore ndahen mjete financiare të komunës nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere për këto programe buxhetore:
   1.1. Zyra e Kryetarit të Komunës;
   1.2. Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
   1.3. Shërbime Publike dhe Emergjenca;
   1.4. Shëndetësi;
   1.5. Mirëqenie Sociale;
   1.6. Kulturë, Rini dhe Sport;
   1.7. Arsim;
   1.8. Drejtoria për Administratë Komunale-nën programi buxhetor i barazisë gjinore;
   1.9. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Në çdo vit fiskal, komuna sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndanë mjete financiare, për Personat fizik (individ) dhe persona juridik (OJQ-të jofitimprurëse) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 5
Planifikimi i buxhetit për përkrahje financiare

Të gjitha programet buxhetore Zyra e Kryetarit, drejtoritë përkatëse dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, gjatë planifikimit të buxhetit planifikojnë buxhetin për subvencione dhe tranfere, i parashohin objektivat, përgatisin projektet dhe aktivitetet konkrete të cilat do të mbështeten nga kategoria ekomomike subvencione dhe transfere.

Neni 6
Ndarja e shumës subvencioneve

1. Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesat e personave fizik (individëve) deri në shumën prej 1,000.00€.3,000.00€. (tremijëeuro)
2. Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje vetëm deri në 500.00euro subvencionohen personat juridik (OJQ-të jofitimprurëse).
3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk zbatohen për rastet e mbështetjes financiare për OJQ-të, e cila mbështetje financiare tejkalon shumën prej pesëqind euro (500€), por zbatohen dispozitat e Rregullores MF-NR–04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përveç në raste të veçanta të përcaktuar me legjislacionin në fuqi kur është e pamundur për shkak të pritet afati kohor për zhvillimin e një thirrje publike.
4. Të gjitha Memorandumet e Mirëkuptimit të lidhura nga Kryetari i Komunës subvencionon sipas shumës së cekur në Memorandum.
5. Kryetari i Komunës në rastet e fatkeqësive të ndryshme apo gjendjes së shpallur emergjente apo të jashtëzakonshme mund të mbështesë financiarisht individët apo familjet të cilët kanë pësuar humbje të konsiderueshme në njerëz apo të mira materiale të vërtetuar me procesverbal dhe foto nga komisioni komunal përkatës apo ndonjë organ tjetër i ngjashëm kompetent për konstatimin, vërtetimin dhe publikimin e gjendjes faktike.

Neni 7
Kërkesat

1. Palët kërkesat i parashtrojnë në Qendrën për Shërbim të Qytetareve (QSHQ) sipas natyrës së kërkesë dërgohen të Zyra e Kryetarit, drejtoritë përkatëse dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Pas pranimit të kërkesave Zyra e Kryetarit, drejtorit përkatëse përgjegjëse për fushat e caktuara dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, me Komision i shqyrtojnë kërkesat e parashtruara nga personat fizik dhe personat juridik-OJQ-të jofitimprurëse në afatin ligjor siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me shkresë i propozojnë Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimit.
3. Kryetari i Komunës merr vendim për miratim apo refuzim për përkrahje financiare në afat të përcaktuara me LPPA dhe e cakton shumë të cilën e vlerëson si të arsyeshme për realizimin e aktivitetit të parashtruar më kërkesë apo projekt.

Neni 8
Personat juridik OJQ-jofitimprurëse

1. Personat juridik jofitimprurës-OJQ-të, kërkesat për përkrahje financiare i parashtrojnë në Qendrën për Shërbim të Qytetareve (QSHQ), se bashku me dokumentet e kërkuara si me poshtë:
    1.1. kërkesën;
    1.2. certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe dëshmia e regjistrimit të personit juridik (OJQ jo

fitimprurëse);

1.3. certifikatën e regjistrimit të OJQ-së dhe numrin fiskal;

1.4. projekt propozimi;

1.5. konfirmimin e xhirollogarisë bankare në emër të (OJQ jo fitimprurëse-personit juridik);

1.6. përformancën e aktiviteteve të realizuara ma parë të lëshuar nga organi që është realizuar projekti i financuar;

1.7. buxhetimi i projektit;

1.8. varësisht nga thirrja publike për përkrahje të OJQ-ve mund të kërkohen edhe dokumente tjera plotësuese.

2. Kërkesat e pa kompletuara si dhe ato qe nuk i plotësojnë kriteret do të refuzohen nga Komisioni i shqyrtimit të kërkesave dhe nuk do të procedohen më tutje.

Neni 9
Përkrahje financiare për Bujqësia dhe Zhvillim Rural

1. Përkrahen financiarisht projektet dhe aktivitetet në bujqësi, si me poshtë:

1.1. projektet e fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, me prioritet për komunën;

1.2. organizimi i panaireve, seminareve, vizitave studimore;

1.3. mbështetja e projekteve me bashkëfinancim;

1.4. ndarja e pajisjeve dhe mekanizimit bujqësor;

1.5. ngritja e serave;

1.6. projekte për perimtari dhe pemëtari;

1.7. projekte për bletari;

1.8. projekte për blegtori;

1.9. projekte për lavërtari;

2. Përkrahen financiarisht projektet për zhvillim rural si me poshtë:

2.1. argotizëm dhe aktivitete alternative;

2.2. ruajtja e burimeve natyrore;

2.3. mbështetja e aktiviteteve artizanale;

2.4. zhvillimi i infrastrukturës rurale, rrugë fushore, ura;

2.5. komuna publikon secilën thirrje publike për aplikim ne ueb faqen zyrtare te saj dhe ne tabelën e shpalljeve.

4. Gjatë ndarjes se subvencioneve dhe grandeve ne bujqësi, ne kushte te barabarta komuna u jep përparësi:

4.1. zonave me prioritet të identifikuara nga komuna;

4.2. pjesëmarrjes se fermerëve/eve ne bashkëfinancim, nëse ne ftesën publike nuk është përcaktuar ndryshe;

4.3. grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara;nevoja të veqanta

4.4. aplikuesve qe nuk kanë fituar subvencione përmes grandeve nga komuna ne tri vitet e fundit.

5. Përkrahen financiarisht edhe kërkesat dhe projektet tjera që nuk janë të cekura në këtë nen dhe që ju ndihmoj fermerëve në zhvillimin e tyre.

Neni 10
Përkrahje financiare për shërbime publike dhe Emergjenca

1. Përkrahen financiarisht e kërkesave, projekteve dhe aktivitetet për shërbime publike dhe emergjenca, si me poshtë:
   1.1. përkrahja e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike për renovimin dhe ndërtimin e shtëpive;
   1.2. demet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore;
   1.3. demet e shkaktuara nga fatkeqësitë tjera te mundshme;
   1.4. mbështetje financiare me përqindje sipas vlerësimit të Komisionit përkatës;
   1.5. projektet për ambient.

Neni 11
Përkrahje financiare për shëndetësi

1. Përkrahen financiarisht individët për kërkesat shëndetësore si me poshtë:
   1.1. për të sëmurët me sëmundje të rënda qe me raport te mjekut kërkojnë trajtim jashtë vendi, ndahen mjete financiare në shumë 1,000.00€;
   1.2. për të sëmurët me sëmundje të diagnostikuar me kancer për herë të parë, ndahen mjete financiare në shumë 500.00€;
   1.3. për të sëmurët me sëmundje kronike ndahen mjete financiare në shumë 150.00€ deri në 300.00€ varësisht nga raporti i mjekut ;
   1.4. të sëmuret që trajtohen me kimioterapi dhe rrezatime në Institutin Onkologjik, dhe të sëmuret që marrin trajtim të përhershëm ju ndahen 15 litra karburant për një seancë në QKUK.
   1.5. të sëmurit të cilët janë të paralizuar ose për shkaqe tjera nuk mund ta përdorin transportin e rregullt të QKMF-së dhe të njëjtit si mjet transporti përdorin automjetet private përkrahen me karburant 0.08 litra karburant për një kilometër.
2. Kriteret që duhet të plotësohen për të përfituar ndihmë financiare shëndetësore janë që të bashkëngjiten dokumentet si me poshtë:
   1.1. kërkesa;
   1.2. letërnjoftimi kopje;
   1.3. raporti mjekësor nga specialisti e konstatuar sëmundja;
   1.4. raporti i mjekut nuk mund të jetë ma e vjetur se gjashtë muaj;
   1.5. konfirmimi i xhirollogarisë bankare.
2. Personat fizik në nevojë përkrahen sipas kësaj Rregulloreje vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 12
Mirëqenia sociale

1. Përkrahen financiarisht kërkesat për mirëqenie sociale, për individ dhe familje si me poshtë:

1.1. për familjet raste sociale dhe familjet me kushte të rënda ekonomike me nevoja për ushqim ndahen mjete financiare 100€, deri në 250€;

hiqet 1.2. për familjet në nevojë-rastet sociale ndahen 150 euro;

hiqet 1.3.familjeve strehuese që kanë fëmijë të strehuar të komunës se Istogut për çdo muaj ju ndahen mjete financiare 100€ për çdo fëmijë;

1.4. për familjet që kanë fëmijë të strehuar ndahen mjete financiare 1,500.00 euro ne vit.

1.5. subvencionohen të gjitha nënat lehona me rastin e lindjes së fëmijës me nga 150€ (njëqindepesëdhjetë euro) 250€(dyqindepesëdhjetë euro);

1.6. subvencionohen nenat vetushqyese me nga 500 euro në vit;

1.7. subvencionohen fëmijët me nevoja të veçanta dhe 100 250 euro në vit;

1.8. subvencionohet pagesa e qeras për familjet ne nevoje dhe kushte të rënda ekonomike.

Neni 13
Përkrahja financiare për kulturë dhe trashëgimi kulturore

1. Me qellim të avancimit dhe promovimit të vlerave kulturore dhe trashëgimisë kulturore, përkrahen aktivitetet si me poshtë:

1.1. festivalet, koncertet, shënimi i datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozitat, veprimtarit teatrale, veprimtarit filmike, botimet e librave dhe promovimet e tyre, artët pamore;

2. Në fushën e trashëgimisë kulturore përkrahen aktivitetet si me poshtë:

2.1. trashëgimia kulturore, hulumtimi i trashëgimisë, gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi, konservimi i vlerave të trashëgimisë, botimi i katalogëve, trajnimet për trashëgimi, shenjëzimi dhe zoonimi i lokaliteteve arkeologjike.

3. Projektet e cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij nenit duhet të jen të arsyetuara mirë dhe me interes të përgjithshëm.

Neni 14
Përkrahja financiare për rini dhe sport

1. Me qellim të fuqizimit të rinisë dhe sportit përkrahen financiarisht projektet e cekura si me poshtë:

1.1. projektet për fuqizimin e rinisë;

1.2. projektet e Organizatave jo qeveritare rinore.

2. Për fuqizimin e sportit përkrahen projektet e cekura si më poshtë :

2.1. përkrahja e klubeve sportive, sportistëve individual, sportistëve që kanë fituar medalje; përkrahja e klubeve sportive të femrave, sportisteve individuale, sportistëve që kanë fituar medalje, masivizimi i sportit për femra;

2.2. bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive që kanë të bëjnë me ngritjen dhe avancimin e sportistëve te rijnë;

2.3. edukimin e tifozëve që janë pjesë përbërëse e sportit përmes trajnimeve, me qëllim të evitimit të dhunës dhe ruajtjes së vlerave fisnike të sportit;

2.4. përkrahja e aktiviteteve sportive të personave me aftësi të kufizuara;

3. Përkrahen klubet sportive që kanë fituar në gara ndërkombëtare zyrtare kualifikuese si me poshtë:

3.1.vendi i parë – 1,500 euro;

3.2.vendi i dytë – 1,000 euro;

3.3.vendi i tretë – 500 euro;

4. Përkrahen sportistët individualë që kanë fituar në gara ndërkombëtare zyrtare kualifikuese si me poshtë:

4.1.vendi i parë – 1,000 euro;

4.2.vendi i dytë – 800 euro;

4.3.vendi i tretë – 600 euro;

Hiqet5. Përkrahja e klubeve sportive që përfaqsojn komunën në gara ndërkombëtarisht do të mbeten automatikisht me shumën prej 10,000 euro sezona.

5. Klubet sportive që e përfaqësojnë Komunën e Istogut në gara ndërkombëtare kualifikuese evropiane, gara zyrtare ndërkombëtare, ose gara tjera me rëndësi të veçantë sportive mund të përfitojnë subvencione deri në shumën prej 10,000 euro, me rekomandim të drejtorisë përkatëse dhe me vendim të kuvendit të Komunës pa qenë e nevojshme zhvillimi i thirrjes publike në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas mundësive buxhetore dhe kritereve si në vijim:

5.1. Klubi sportiv duhet të ketë së paku 80% të sportistëve të regjistruar në ekipin garues me prejardhje vendore;

5.2. Të deshmoj pjesëmarrjen ose kualifikimin në gara ndërkombëtare përmes dokumentacionit zyrtar të organizatorit, federatës përkatëse;

5.3 Të deshmoj shpenzimin e rregullt të subvencioneve te vitit paraprak nese ka përifituar;

5.4. Të paraqes planin e aktiviteteve sportive dhe planin financiar për sezonën për të cilën kërkohet subvencioni.

Hiqet. Përkrahja e OJQ-ve përmes vendimeve ad-hoc sipas agjendave për gara nderkombetare dhe finaleve vendore.

Neni 15
Përkrahje financiare për Arsim

1. Përkrahen financiarisht kërkesat dhe projektet për aktivitetet e arsimit si me poshtë:

1.1. përkrahen OJQ-të jo fitimprurëse për projekte e arsimit-sipas Rregullores MF-NR–04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2. Përkrahja e nxënësve -fitues në garat shkencore regjionale, shtetërore apo ndërkombëtare:

2.1. vendi i parë –1000 euro; Ndërkombëtare vendi i parë

2.2. vendi i dytë(hiqet) –500 euro; Regjionale vendi i parë

2.3. vendi i tretë(hiqet) –300 euro. Shtetërore vendi i parë

3. Komuna e Istogut përmes thirrjes publike ndan bursa për të gjith studentet e regjistruar ne vitin e par të studimeve në një institucion të akredituar të arsimit të lartë, në vitin akademik në të cilin e kan përfunduar arsimin e mesem të lartë.
4. Shuma e bursës për studentët përfitues në vitin e parë të studimeve është 650 euro për vitin akademik.
5. Të drejtën për ta vazhduar përfitimin e bursës në vitet pasuese studentët e fitojnë me kusht qe vitin akademik ta kenë të përfunduar brenda afatit të rregullt akademik, me deshmi nga institucioni ku i ndjek studimet.
6.Për studentët që studiojnë drejtimet deficitare të matematikës, kimisë dhe fizikës , shuma e bursës për vitet pasuese të studimeve është 800 euro për vit akademik, me kusht që të plotëssojnë kriterin e percaktuar në paragrafin nr.5.
7. Studenti nuk mund të përfitoj bursë nga Komuna e Istogut nese për të njejtin vit akademik ka përfituar bursë nga një institucion tjeter publik ose privat.

Neni 16
Përkrahja financiare për projektet për të drejtat e njeriut dhe mundësi të barabarta gjinore

1.Përkrahja financiare e aktiviteteve për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar si dhe mundësi të barabarta gjinore, si me poshtë:

1.1. përkrahja financiare e aktiviteteve për të drejtat e njeriut;
1.2. përkrahja financiare e aktiviteteve vetëdijesuese për arritjen e barazisë gjinore;
1.3. përkrahja financiare e aktiviteteve për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat;
1.4. përkrahja financiare e aktiviteteve për të drejtat e fëmijëve dhe
1.5. përkrahja financiare e aktiviteteve të vetëdijesimit dhe parandalimit të dhunës në familje.

Neni 17
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Zyra komunale për komunitete dhe kthim përkrah financiarisht personat fizik (individ) dhe persona juridik (OJQ-të jofitimprurëse) sipas natyrës së kërkesave të parashtruara, kërkesat e pa arsyeshme dhe të pa kompletuara refuzohen nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave i formuar nga Zyra Komunale për komunitete dhe kthim.

Neni 18
Subvencionet për Sindikata

1. Komuna mund të ndajë subvencione sipas kërkesave të sindikatës të arsyetuara mirë dhe me interes të përgjithshëm, për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre që konsiderohen të nevojshme për të punësuarit të cilët përfaqësohen nga Sindikatat.
2. Sindikatat të cilat parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si me poshtë:
   2.1. vendimin e regjistrimit të Sindikatës;
   2.2. certifikatën e numrit fiskal;
   2.3. konfirmimin e xhirollogarisë bankare të Sindikatës;
   2.4. projekt-propozimin;
   2.5. buxhetimin e projektit;
3. Varësisht nga lloji i kërkesës dhe projektit mund të kërkohen edhe dëshmi tjera plotësuese.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje për ndarjen e Subvencioneve, shfuqizohet Rregullorja 01numer 42/2014 për ndarjen e Subvencioneve si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që janë nxjerr nga Kryetari i Komunës e që janë në kundërshtim me këtë Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve.

Neni 20
Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset Kryetari i Komunës, drejtorit përkatëse dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Neni 21
Hyrja ne fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi Komunal kjo Rregullore për ndarjen e Subvencioneve hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës Ministrin e Administrimit Pushtetit Lokal në pajtim me nenin 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Komunale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve komunale dhe 7(shtatë) ditë pas shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Enver Rugova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

REFERENCË:		13 Nr.61/2026			
PËR/ZA/TO:		Ilir Ferati, Kryetar i Komunës së Istogut Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa			
NGA/OD/FROM:		Besnik Metaj, Zyrtar i Lartë I tatimit në Pronë/Sektori i Tatimit në Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Komuna e Istogut			
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:		**Propozim për përcaktimin e normave tatimore për vitin tatimor 2027**, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-224			
Nr. i zyrës Br. kancelarije Room No.:		Lokacioni: Kucni: Extension:		Datë: Datum: Date:	08.10.2026
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					menjëherë

Sektori i Tatimit në Pronë, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në zbatim të plotë të neneve 7 dhe 9 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-224, ju paraqet këtë **propozim për përcaktimin e normave tatimore që do të aplikohen për vitin tatimor 2027.**

Propozimi është përgatitur pas shqyrtimit të normave tatimore të aplikuara për vitin 2026 dhe përfshin normat e propozuara për vitin 2027, kufijtë ligjorë përkatës dhe vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me legjislacionin në fuqi, për t'u proceduar më tej sipas kompetencave dhe procedurave të përcaktuara me ligj.

STRUKTURA E PROPOZUAR E NORMAVE TATIMORE PËR VITIN 2027

Nr.	Kategoria e pronës	Norma 2026	Norma e propozuar 2027	Kufiri ligjor sipas Nenit 9	Vlerësimi
1.1	Njësi bujqësore të parcelave	0.15%	0.10%	Prej 0.15% deri në 0.5%	**Zbritje 0.5%**
1.2	Njësi bujqësore të objekteve	0.15%	0.10%	Prej 0.15% deri në 0.5%	**Zbritje 0.5%**
1.3	Njësi pyjore të parcelave	0.15%	0.10%	Prej 0.15% deri në 0.3%	**Zbritje 0.5%**
1.4	Njësi rezidenciale të parcelave	0.15%	0.10%	Prej 0.15% deri në 1%	**Zbritje 0.5%**
1.5	Njësi rezidenciale të objekteve	0.20%	0.20%	Prej 0.15% deri në 1%	**Në përputhje**
1.6	Njësi komerciale të parcelave	0.15%	0.15%	Prej 0.15% deri në 1%	**Në përputhje**
1.7	Njësi komerciale të objekteve	0.20%	0.20%	Prej 0.15% deri në 1%	**Në përputhje**
1.8	Njësi industriale të parcelave	0.20%	0.20%	Prej 0.15% deri në 0.8%	**Në përputhje**
1.9	Njësi industriale të objekteve	0.20%	0.20%	Prej 0.15% deri në 0.8%	**Në përputhje**

Duke u bazuar në sa më sipër, propozohet që ky material të shqyrtohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe, pas vlerësimit përkatës, t'i përcillet Kryetarit të Komunës për procedim të mëtejshëm, në përputhje me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Me respekt,